



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
K R Y E T A R I

Nr. 1194/6 Prot.

Tiranë, më 08/05/2016

V E N D I M

Nr.50, Datë 08/05/2016

PËR

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT Të Kryer Në
Bashkinë Polican, "MBI AUDITIMIN E LIGJSHMËRISË DHE
RREGULLSHMËRISË FINANCIARE"**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit Tematik dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të neneve 10 dhe 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

V E N D O S A:

I. "Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare" të ushtruar në Bashkinë Poliçan, për periudhën 01.01.2014 deri më 31.12.2015.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE:

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" nenet 21-3 -Funksionimi dhe kompetencat e njësisve të vetëqeverisjes vendore dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" Kap IV, - Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, **nga ana e titullarit të njësisë publike**, të nxirren aktet

administrative përkatëse (vendimet ekzekutive). **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin me qëllim sistemimin, likuidimin e vlerave në shumën **52,356,556 lekë** dhe veçanërisht arkëtimin e të ardhurave të munguara nga taksat vendore në vlerën 48,351,870 lekë, **si më poshtë:**

1. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e ushtruar nga KLSH, në Bashkinë Poliçan në 6 mujorin e parë të vitit 2012 për aktivitetin financiar 2010-2011 janë dërguar përfundimet e auditimit me shkresën nr. 418/7, datë 30.06.2012 për të cilën janë kyer kontabilizimet për dëmin ekonomik në vlerën prej 304,424 lekë, por deri më datën 26.02.2016 ishte arkëtuar vlera prej 229,800 lekë ose në masën 70% të rekomandimit, duke mbetur pa u arkëtuar vlera prej **74,624 lekë**.

Rekomandimi: Bashkia Poliçan të marrë masë për arkëtimin e detyrimit të pa arkëtuar nga 7 persona në vlerën prej **74,624 lekë**, respektivisht: Q.Z. në vlerën 2,506 lekë, Sh.D. në vlerën 8,164 lekë, F.T. në vlerën 804 lekë, R.B. në vlerën 8,200 lekë, R.G. në vlerën 8,800 lekë, P.Sh. në vlerën 10,200 lekë dhe A.Sh. në vlerën 35,950 lekë.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe të dhënat e paraqitura në faqen elektronike të Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat rezulton se Bashkia Poliçan nuk ka paguar që nga viti 2013 kontributin për sigurimet shoqërore e shëndetësore të punonjësve dhe tatimin mbi të ardhurat personale **për 108 punonjes** në shumën **19,852,773 lekë**, nga të cilat detyrime vlera **16,914,031 lekë**, për të cilat llogaritet edhe kamat vonesat sipas formulës të instaluar në sistemin e Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat **në vlerën 3,038,742 lekë**, në kundërshtim me nenin 14, të ligjit nr. 9146, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, i ndryshuar dhe nenin 33, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatim mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Rekomandimi: Nga ana e kryetarit të Bashkisë Poliçan, në zbatim të shkronjës (ç) nenit 64 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015” Për vetëqeverisjen vendore”, të përgatitet një material për në Këshillin Bashkiak në lidhje me gjendjen financiare të Bashkisë dhe 2 njësisive administrative për 6 mujorin e parë 2016 dhe gjetjen e fondeve për pagesën e detyrimeve të papaguara, për 108 punonjesit e Bashkisë në shumën 19,852,773 lekë.

Brenda datës 10.07.2016

3. Gjetje nga auditimi: Nga 15 mjete që disponon në inventar Bashkia vetëm për 3 prej tyre janë paguar taksat vjetore dhe janë prerë siguruacionet, ndërsa për 12 mjetet e tjera nuk janë paguar asnjë vit taksat vjetore dhe nuk janë të siguruara, ndërkohë nuk është bërë çregjistrimi i mjeteve në Drejtorinë Rajonale të Transporteve, në kundërshtim me nenet 99-100 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor në R.SH”, i ndryshuar. Për pasojë për këto mjete Bashkia do të vazhdojë të paguajë taksat e prapambetura dhe kamat vonesat përkatëse duke shtuar shpenzimet e panevojshme.

Rekomandimi: Bashkia Poliçan bazuar në nenet 99-100 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor në R.SH” i ndryshuar, të marrë masa për çregjistrimin e mjeteve të transportit të panevojshme, me qëllim uljen e shpenzimeve, duke propozuar në Këshillin Bashkiak edhe vendosjen e normativave të harxhimit të karburantit sipas Tipit të secilit Mjet.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Për funksionimin e administratës së bashkisë Poliçan, me vendimi e kryetarit të Bashkisë nr. 37, datë 31.08.2015, është miratuar rregullorja mbi organizimin e brendshëm të punës së aparatit të Bashkisë Poliçan, por në nenin 18 të saj, Drejtoria e Kordinimit dhe Shërbimeve Publike, nuk janë përcaktuar detyrat e Inxhinierit mekanik, transportit dhe emergjencave civile dhe detyrat e Ekonomistit.

Rekomandimi: Bashkia Poliçan të marrë masa dhe të hartojë detyrat e inxhinierit mekanik të transportit, duke i pasqyruar në Rregulloren e Bashkisë edhe elementë të tjera në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Bashkia Poliçan bazuar në VKM nr. 212, datë 30.03.2012 “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e njësive të auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik nuk ka krijuar strukturë auditimi të brendshëm, pasi nuk ka pasur ndërmarrje në vartësi dhe auditimin e aktivitetit e ka kryer Njësia e Auditimit të Brendshëm e Prefekturës Berat dhe KLSH.

Rekomandimi: Bashkia Poliçan të marrë masa për organizimin shërbimit të auditimit të brendshëm në përputhje me ligjin nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditin e brendshëm publik” neni 10 “*Organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm*” dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin Publik”.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga ana e Drejtores së Taksave nuk është ndarë detyra për secilin punonjës, edhe pse nga ish-komunat është dorëzuar detyra me procesverbal, por ndërkohë nuk është bërë një inventar fizik i dosjeve, të vetë Bashkisë Poliçan, me qëllim që të evidentohet dokumentacioni që mungonte, si, deklaratat e qarkullimit të xhiros, Njoftim- vlerësimet e detyrimeve tatimore, fotokopje e dokumentit të pagesës së taksave. Duke shkelur VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”.

Rekomandimi: Drejtoria e taksave Bashkia Poliçan të marrë masa për ndarjen e detyrave për secilin punonjës të zyrës tatimeve, duke u caktuar numrin e bizneseve sipas NUIS (Nipteve) apo fshatrave për taksën e tokës dhe taksat e popullatës.

Dosjet e subjekteve tatimpaguese të plotësohen me deklaratat parashikuese të qarkullimit vjetor; njoftim vlerësimi tatimor; njoftim detyrimi; dokumenti i pagesës së detyrimit, (mandat arkëtimi); gent-planet apo planimetritë për taksën e ndërtesave, aktkonstatimet apo aktverifikimet për mbylljen e aktivitetit, të konfirmuara dhe nga Policia bashkiake, të përcaktuara nenin 29 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për Procedurat tatimore në R.SH.*” i ndryshuar.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria e taksave nuk është krijuar në regjistër me të dhënat e kontratave të dhëna me qera për tokat bujqësore të pa ndara, pyjet për vendepozitim materialesh inerte, vendosje antenash televizori etj.

Rekomandimi: Zyra e taksave të Bashkisë Poliçan të marrë masa për hapjen e një regjistri me të dhënat e kontratave të qerasë me të gjitha elementët dhe sipas viteve, duke i ndjekur në vazhdimësi arkëtimin e tyre.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Poliçan më datën 31.12.2015 nga mos pagesa e taksave dhe tarifave vendore rezultojnë debitorë 42 **Biznese në vlerën 5,184,965 lekë**, nga e cila 4,176,374 lekë janë detyrime të papaguara, ndërsa 1,008,591 lekë përfaqëson kamat vonesa për mos pagesa në afat.

Nga vlera e debitoreve deri më 31.12.2015 prej 5.184.965 lekë, 27 % e tyre ose 1,487,810 lekë janë krijuar gjatë viteve 2012-2014, respektivisht i përkasin Bashkisë Poliçan 17 subjekte në vlerën prej 1,487,810 lekë dhe Njesisë administrative Vertop 29 subjekte në vlerën 3,697,155 lekë.

Rekomandimi: Nga drejtoria e taksave të Bashkisë Poliçan të merren masa për arkëtimin dhe të bëhen njoftim vlerësimet tatimore për 42 **Biznese debitorë në vlerën 5,184,965 lekë**, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, **duke ndjekur rrugët e mëposhtme:**

a. Tu dërgohen Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

b.Ti kërkohet Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit vendosja e barrës siguroese, (për mjetet) dhe Zyrës Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë) bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

c. Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, të ndryshuar, ndaj tyre të llogariten kamat vonesa (gjobë në masën 0,06% kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë).

d.Drejtoria e taksave për mos pagesën e taksave në afat të aplikojë dënim me gjobë për pagesat e vonuara, në masën 0,06% kamat vonesë për çdo ditë vonesë por jo më tepër se 365 ditë, bazuar në nenin 114 të ligjit nr. 9920, dt.19.05.2008.

e.Nga ana e Drejtorisë së taksave Bashkia Poliçan të listohen në mënyrë elektronike **abonentët familjarë** dhe të merren masa për arkëtimin e taksave të tokës **nga 2439 fermerë** për vlerën **43.166.905 lekë**, taksa e popullatës për shumën **2.088.000 lekë**, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile. Në zbatim të pikës 71, të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, **të njoftohen** tatimpaguesit familjarë (të Bashkisë Poliçan dhe 2 njësitë Administrative Vertop dhe Terpan), për të paguar detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak, nëpërmjet dërgimit të Njoftim Vlerësimi me anë të Zyrës postare, për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të papaguara, si taksën e tokës, banesave dhe tarifave etj.si më poshtë:

Nr	Emertimi	Sipas Bilancit Kontabel me dt. 31.12.2015		Sipas Listave analitike				Debitor tjer, ndertese pastr etj Leke
		Nr	Leke	Biznese private		Debitoret e Tokes		
				Nr	Leke	Nr familjeve	Leke	
a	b	1	2	3	4	5	6	7
1	Bashkia Poliçan		4.026.751	17	1.487.810	257	450.941	2.088.000
2	Njesia Administ Vertop		17.196.240	29	3.697.155	997	13,499,085	
3	Njesia Administ Terpan		29.216.879			1185	29.216.879	
	SHUMA		50.439.888	46	5.184.965	2.439	43.166.905	2.088.000

Shënim: Listat e debitorëve të biznesve dhe fermerët për taksën e tokës për Bashkinë Poliçan dhe 2 njësitë administrative Vertop dhe Terpan, të fiksuara më datën 31.12.2015, ndodhen në Drejtorinë e taksave Bashkia Poliçan.

Menjëherë

9.Gjetje nga auditimi:Bashkia Poliçan duke qenë se ka mazhorancën e aksioneve në Ujësjiellës sha. Poliçan dhe për vitet 2013-2015 ka caktuar dhe paguar në Këshillin mbikqyrës, 2-3 persona. Ndërkohë nuk është bërë e mundur lidhja e një marëveshje për caktimin e Ujësjiellës sha Poliçan si agjent tatimor, me qëllim implementimin e pagesës së taksave vendore, së bashku me faturat e ujit të pijshëm, marëveshje e cila do të rriste arkëtimin e taksave vendore dhe do rigjenerojë të ardhura për bashkinë Poliçan.

Rekomandimi: Bashkia Poliçan, të përgatisë aktmarrëveshjen për pagesën e taksave dhe tarifave nga përdoruesit, së bashku me faturat e ujit të pijshëm, nëpërmjet Ujësjiellës sh.a, Poliçan, e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak, bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5 shkronja ii, nenin 7 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore” i ndryshuar, pikës 7.1 të UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore”.i ndryshuar.

Në mbledhjen e rradhës të Këshillit Bashkiak

10.Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Poliçan nuk janë ndërmarrë hapat ligjore për regjistrimin e pronave në pronësi të Bashkisë në ZVRPP Skrapar, në zbatim të kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar.

Rekomandimi: Bashkia Poliçan të marrë masat e nevojshme për regjistrimin e pronave dhe për krijimin e regjistrit të pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në përdorim të Bashkisë Poliçan, në zbatim të VKM nr. 500 datë 14.08.2001.

Në vazhdimësi

11. Gjetje nga auditimi: Për të gjitha asetet nuk është hapur regjistri kontabël, në kundërshtim me kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pasi nëpunësi autorizues nuk ka caktuar nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit kontabël të gjithë aktiveve, që zotëron apo ka në administrim Bashkia Poliçan.

Po kështu në kundërshtim me pikën 31/d të udhëzimit të mësipërm, nuk është mbajtur regjistri i veçantë për secilën nga pasuritë e dhëna me qira ku të përcaktohet sipërfaqja e objektit në metra katrorë, numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës, afati i qirasë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore dhe arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik.

Rekomandimi: Bashkia Poliçan, pas azhurnimit të aseteve të kaluara në pronësi me VKM nr. 2017, datë 09.03.2011 dhe aplikimit për regjistrim në ZVRPP Skrapar në pronësi të Bashkisë, përkatësisht në regjistrin e kartelave të pasurive të paluajtshme, të krijojë dhe mbajë regjistrin kontabël të tyre, si dhe të përditësojë regjistrin mbi pasuritë e paluajtshme të dhëna me qira.

Në vazhdimësi

12. Gjetje nga auditimi: Për 6 raste të dhënies me qira të aseteve publike nga ish-Komunat (Vertop dhe Terpan) të përthithura nga Bashkia Polican, sipërfaqja e dhënë me qira nga komuna është në kundërshtim me gjitha kriteret dhe procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 17 të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për Fondin Kullosor” i ndryshuar dhe Udhëzimi Nr. 4, Datë 22.04.2013 “Për Përcaktimin e Kriterëve të Konkurrimit dhe Procedurën e Dhënies në Përdorim me Kontratë Qiraje të Fondit

Pyjor dhe Kullosor Publik”, pasi këto sipërfaqe përdoren për aktivitet ekonomike të depozitimit të gurit, gëlqeres apo blloqeve.

Rekomandim: Bashkia Poliçan të marrë masa në rrugë administrative dhe ligjore për anulimin e 6 kontratave të qirasë të lidhura në kundërshtim me kriteret dhe detyrimet e përcaktuara në ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për Fondin Kullosor” i ndryshuar dhe Udhëzim Nr. 4, Datë 22.04.2013 “Për Përcaktimin e Kritereve të Konkurrimit dhe Procedurën e Dhënies në Përdorim me Kontratë Qiraje të Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik”.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Blloqet e vendosjes së gjobave të Policisë Bashkiake Poliçan, nuk janë trajtuar si letra me vlerë, nuk janë bërë hyrje në magazinë, nuk është bërë shoqërimi i dorëzimit të tyre me proces verbal nga një punonjës tek tjetri, ato gjenden fizikisht në arkivin e Bashkisë. Nuk ekziston dokumentacion zyrtar se nga janë marrë blloqet e gjobave të Policisë bashkiake dhe nuk administrohen si letra me vlerë, në kundërshtim me VKM nr. 1497, datë 19.11.2008 për “Shtypjen e letrave me vlerë” i ndryshuar me VKM nr. 277, datë 6.4.2011 dhe pika 2, VKM nr. 393 datë 18.06.2014.

Rekomandim: Inspektori i Policisë Bashkiake të marrë masa që për çdo rast të lëvizjes së punonjësve të Policisë Bashkiake, të bëhet dorëzimi dhe marrja e blloqeve në dorëzim nga njëri punonjës tek tjetri me procesverbal. Blloqet e gjobave të Policisë bashkiake të inventarizohen me një komision të veçantë dhe të bëhen hyrje në magazinë, duke i administruar si letra me vlerë.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Niveli arsimor i punonjësve të policisë Bashkisë Poliçan nuk përputhet me nivelin arsimor dhe profesional dhe moshën e përcaktuar në neni 7 të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 i ndryshuar me ligjin nr. 8335, datë 23.04.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë të bashkisë dhe të komunës” dhe kërkesat e urdhrimit të përbashkët Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 1530, datë 7.04.2003 si dhe kushtet aktuale të mungesës së personelit të kualifikuar në këtë drejtim.

Rekomandim: Të kualifikohen punonjësit e policisë sistematikisht në zbatim të ligjit nr. 8335, datë 23.04.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë të bashkisë” dhe kërkesat e urdhrimit të përbashkët Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 1530, datë 7.04.2003.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Për të 3 vitet objekt auditimi 2013, 2014 dhe 2015 për 5 punonjësit pjesë e shërbimit civil, nuk ishte bërë vlerësimi vjetor i punonjësve, në zbatim të nenit 16 dhe 29 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, udhëzimi i KM nr. 5, datë 19.12.2007 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 2, datë 07.07.2000” “Për sistemin e vlerësimit të arritjeve vjetore individuale të nëpunësve civilë”, neneve 62 dhe 69 -Vlerësimi i rezultateve në punë, të ligjit nr. 152/2013 datë “Për Nëpunësit Civil” dhe VKM nr. 109, datë 26.02.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësit civil”, mbështetur në ligjin për statusin e nëpunësit civil, bën vlerësimin e punës gjatë dhe në fund të periudhës së provës dhe ia paraqet eprorit direkt.

Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve njerëzore së bashku me Drejtorinë juridike të marrë masa për vlerësimin e aritjeve individuale të punonjësve pjesë e shërbimit civil në periudhën në vazhdim, brenda 6 mujorit të parë 2016 dhe në muajin nëndor 2016.

Në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Mbështetur në pjesën VI, kreu I, nenet 105-109, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”; Kreu V, nenet 9-14 dhe Kreu VII-të- Funkzioni dhe kompetencat e njësive të vetëqeverisjes vendore, nenet 21-33 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe UMF, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, -Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike të nxirren aktet administrative përkatëse (Vendimet ekezekutive) dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit dhe (Nëpunësi zbatues), të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare, me qëllim **shpërblimin e dëmit në vlerën 3,250,093 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Këshilltaret e Bashkisë Poliçan edhe pse nuk kanë marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë paguar për vlerën **1,047,200 lekë**, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 29, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, si dhe rregullores së Këshillit Bashkisë nenit 37 rregullores së këshillit të miratuar me vendimin nr. 14, datë 14.07.2011 ku shprehet se: në mbledhjen e Këshillit Bashkiak mbahet procesverbal nga punonjësi i caktuar.

Rekomandim : Bashkia Poliçan të marrë masat, për të kontabilizuar dhe kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **1,047,200 lekë**, respektivisht vlera 934,370 lekë, për periudhën janar 2013-30 Qershor 2015 dhe vlera 130 900 lekë për periudhën Korrik-Dhjetor 2015, sa janë paguar në kundërshtim me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 dhe rregulloren e brendshme të këshillit Bashkiak.

Mënjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Bashkia Poliçan ka kryer pagesa të tepërta në vlerën, **181,000 lekë** ndaj operatorit ekonomik “I” shpk, në situacionimin e volumeve të punimeve për 2 zëra punimesh me diferenca volumesh të pa kryera dhe situacionimin e vlerës 20% të TVSh-së për pajisjet kondicionerë, në objektin “Rikonstruksion i Zyrave të Administratës së Bashkisë Poliçan”, në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 2210/16, datë 14.12.2015 dhe UKM nr. 2, date 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”.

Rekomandimi: Bashkia Poliçan të marrë masadhe të ndjek procedurën ligjore për arkëtimin e vlerës **181,000 lekë**, nga operatori ekonomik “I” shpk, sa paguar për situacionimin e volumeve të punimeve të pa kryera në objektin “Rikonstruksion i Zyrave të Administratës së Bashkisë Poliçan”.

Mënjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Bashkia Poliçan ka kryer pagesa të tepërta në vlerën, **172,050 lekë** ndaj operatorit ekonomik “B” shpk, në situacionimin e volumeve të punimeve për 3 zëra punimesh me diferenca volumesh të pa kryera, ose të realizuara me cilësi të

dobët, në objektin “Rikonstruksion i Kopshetit të fëmijëve nr. 2”, Bashkia Poliçan, në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 739/19, datë 8.10.2014.

Rekomandimi: Bashkia Poliçan, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **172,050 lekë**, nga operatori ekonomik “B” shpk, sa paguar në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 739/19, datë 8.10.2014, për situacionimin e volumeve të punimeve të pa kryera në objektin “Rikonstruksion i Kopshetit të fëmijëve nr. 2”, Poliçan.

Mënjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimin nr. 236, datë 18.08.2015, për zhvillimin e një aktiviteti, janë paguar 10 interpretues (këngëtarë), ndërkohë nuk është kryer ndalesa e tatimit në burim në masën 15 % ose në vlerën prej **300,000 lekë** e cila përbën **mungesë të ardhurash (dëm ekonomik) në buxhetin e shtetit** (2,000,0000:15%), në kundërshtim me nenin 33, pika 1 shkronja “f” të ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998” Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar me ligjin nr. 156/2014 datë 27.11.2014.

Rekomandimi: Vlora e tatimit në burim të pa ndalur për vitin 2014, prej **300,000 lekë** të dëmshpërblehet nga urdhëruesit e pagesave z. A.Z. kryetar i Bashkisë Poliçan në cilësinë e titullarit dhe znj. V.A. me detyrë Drejtores e Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues, e cila nuk ka kryer ndalesat në listëpagesat e likuidimit të tyre.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i pagesës së taksës së sheshit të ushtrimit të aktivitetit të biznesit rezulton se 5 subjekte të cilët ushtrojnë aktivitet përpunim guri apo pllaka guri, nuk ishin kryer të sakta përlogaritjet për sipërfaqen e ndërtesave të cilën e kanë në përdorim, duke mos paguar taksën e ndërtesës dhe krijuar të ardhur të munguar për Buxhetin e Bashkisë Poliçan në vlerën **155,430 lekë**.

Rekomandim: Nga ana e Zyrës taksave Bashkia Poliçan, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, **të nxirren njoftim vlerësimit tatimore në vlerën 155,430 lekë** për 5 subjektet e mëposhtme:

Nr.	Emer Mbiemer	Aktiviteti	K.Qer aje	Nr nipt	P.ve rbal	Nderte s/m ²	Shesh /m ²	Diferen cat per sheshi n	Llog e efektit M ² x30lek ex 3 vite	Vendi i ushtrim te aktivitetit
a	b	c	3	4	5	6	7	8	9	10
1	X	Perp.guri		K82913007J	+	218	874	92	8.280	F.Peshtan
2	K	Perp.guri		K19003407J	+	963	1270	233	20.970	F.Peshtan
3	D	per.guri		L02719001B	+	140	1800	200	18.000	Vertop
4	A	Pllaka guri	po	K32803014D	+	70	1153	223	20.070	Vertop
5	A	per.guri	po	K79631401K	+	94	1885	979	88.110	Vertop
	Totali								155.430	

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Tarifat e pagesës së qirave janë llogaritur bazuar në VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” Lidhje nr. 14, ndërkohë që llogaritjet duhet të kryheshin sipas Lidhjes nr. 6 “Për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkte nga sipërfaqja (kariere) gurore me afat leje përdorim 6-10 vjet, tokë inproduktive me tarifën 440.000 lekë/ha”.

Përveç kësaj nga matjet e bëra në terren nga vetë Bashkia Poliçan, në lidhje me sipërfaqen reale që shfrytëzojnë aktualisht 2 subjektet respektivisht: “A...” sh.p.k dhe

“A...” sh.p.k, rezulton se këto 2 subjekte kanë mbi sipërfaqen reale të kontratave të lidhura prej 1,202 m², duke mos paguar tarifën për sipërfaqen shtesë duke krijuar një mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Poliçan në vlerën **65,675 lekë**, respektivisht:

a.subjekti “A...”sh.p.k. pajisur me lejë mineare nr. 766, dt.16.06.2004 shfrytëzim Gëlqere një sipërfaqe prej 0.15 Km² ose 15 ha, (aktivitetin e ushtron ne rrethin e Skraparit) , ka në përdorim rreth 223m² më tepër nga kontrata duke sjell efekt ekonomik në masën 5,575 x 3 vjet (2013-2014 -2015) = **16,725 lekë**.

b.subjekti “A...” sh.p.k, i pajisur me lejë minerare nr. 1233, datë 16.09.2008 shfrytëzim Gëlqeror pllakor për sipërfaqe 0,103 Km² ose 10.3 ha, (aktivitetin e ushtron ne rrethin e Skraparit), rezulton se ka në përdorim rreth 979 m² sipërfaqe më tepër nga kontrata duke sjell efekt ekonomik në masën 24,475 lekë x 2 vjet, (vitet 2014-2015) = **48,950 lekë**.

Rekomandimi: Bashkia Poliçan të marrë masa për arkëtimin e diferencës së sipërfaqes të cilën e përdorin mbi kontratat e lidhura në vlerën prej **65,675 lekë**, respektivisht:

1.Subjekti “A...” sh.p.k. për vlerën **16,725 lekë**

2.Subjekti “A...” sh.p.k, për vlerën **48,950 lekë**.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Sektori i Shërbimit Social pranë Bashkisë, në disa raste ka konstatuar parregullsi në dhënien e ndihmës ekonomike te konstatuara nga inspektorati i qarkut në përgatitjen e dokumentacionit të ndihmës ekonomike për të cilat nuk janë zbatuar rekomandimet, ndalesat e paguara në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe që nuk janë arkëtuar nga 3 persona në vlerën **6,156 lekë**.

Rekomandim: Sektori i Shërbimit Social për dhënien e ndihmës ekonomike, të kompletojë të gjitha dosjet me dokumentacionin e nevojshëm ligjor dhe të kryej ndalesat të cilat janë paguar në kundërshtim me ligjin dhe dispozitat zbatuese duke arkëtuar detyrimin prej 6,156 lekë ndaj individëve të përcaktuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Për 2 vitet 2013-2015, nga policia Bashkiake Poliçan, për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor dhe një rast të ndërtimit pa leje, ndaj 15 kundravajtësve janë vendosur 15 gjoba në vlerën 20,000 lekë. Deri më datën 26.02.2016 ishin arkëtuar nga 16 kundërvajtës vlera prej 16,000 lekë, ndërkohë për rastet e pagesës me vonesë nuk janë llogaritur kamat vonesat në vlerën 19,420 lekë. Kanë mbetur pa u arkëtuar edhe nga 4 kundërvajtës vlera e gjobave prej 4,000 lekë.

Rekomandim: Nga Policia Bashkiake Poliçan bazuar në nenin 14 pika 2 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar dhe nenet, 9, 22 dhe 30 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, të merren masa dhe të ndiqet në rrugë administrative arkëtimi i vlerave të gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake dhe të penaliteteve në vlerën gjithsej 23,420 lekë, respektivisht për 4 kundërvajtës në vlerën 4,000 lekë dhe kamat vonesa nga kundërvajtësit për vlerën 19,420 lekë, në të kundërtën vlera prej 23,420 lekë, të paguhet nga punonjësit e policisë të cilët nuk kanë marrë masa për ekzekutimin e këtyre gjobave.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga struktura e IMT-së, për 7 vendime për prishje për 13 objekte konstatohet se prishja e objekteve nuk është shoqëruar me gjobë dhe me faturë

përlllogaritje të shpenzimeve të prishjes së objektit të cilat i ngarkohen subjektit të kundërligjshëm duke vepruar në papajtueshmëri me pikën 8 të VKM-së nr.862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga INUK dhe INUV” i ndryshuar, përbën të ardhur të munguar me efekt dëm ekonomik për buxhetin e njësisë vendore, Bashkisë Poliçan e cila përlllogaritet minimalisht në vlerën 13 x100,000lekë =1,300,000 lekë.

Rekomandim: Bashkia Poliçan dhe IMTV të marrin masa për arkëtimin e shumës 1,300,000 lekë, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi Procedurës Civile” i ndryshuar dhe ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 ndryshuar me ligjin nr. 183/2014 datë 01.04.2013 “Për Inspektimin dhe mbrojtjen e Territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”

Menjëherë

C. MASA DISPLINORE:

C-I.Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

Mbështetur në nenin 58 “llojet e masave disiplinore” shkronja “c”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64 shkronjat “g” dhe “k” të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë që ti kërkojë Komisionit disiplinor, pranë Institucionit Tuaj, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në 1 vit’, për:**

1. znj. A.C. emëruar në fillim specialiste e taksave me Urdhrin nr. 07, datë 15.01.2014, përfituar statusin e nëpunësit civil më datë 14.10.2014 dhe më vonë më datën 26.10.2015 emëruar Drejtore e Zyrës taksave Bashkia Poliçan e në vazhdim.

Për shkeljet e mëposhtme:

a. Me veprime dhe mosveprime të Zyrës së Taksave ka sjellë mos realizimin e të ardhurave në vlerën 5,184,965 lekë, nga 42 Biznese debitore, më datë 31.12.2015. Kjo vlerë ndahet në 4,176,374 lekë janë detyrime të papaguara dhe 1,008,591 lekë janë interesa për mos pagesa në afat.

b. Për mos marrjen e veprimeve për vjeljen e taksave vendore, si më poshtë:

-Nuk i është kërkuar Këshillit të Bashkisë, ndërhyrje me forcë te Policisë Bashkiake, për vjeljen e detyrimeve të subjekteve debitore, siç parashikohet në nenin 5, shkronja “ç” nënpika “iii”, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”.

-Nuk ka kërkuar që ndaj subjekteve debitore të vendosej bara siguroese (Drejtorinë Rajonale të Transportit për mjetet), apo Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, kjo bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008”Për Procedurat tatimore” i ndryshuar.

-Për mos nxjerrjen e Njoftim Vlerësimit tatimor për popullatën në kundërshtim me nenin 70, pika 3 “ E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “ Për Procedurat tatimore” i ndryshuar.

-Për mos pagesën e taksave në afat për vitin 2015, nuk ka aplikuar dënim me gjobë për pagesat e vonuara, në kundërshtim me nenin 114, të ligjit nr. 9920, dt.19.05.2008 ”Për procedurat tatimore”, i ndryshuar me ligjin nr.164/2014 në masën 0,06% kamat vonesë për çdo ditë vonesë por jo më tepër se 365 ditë.

-Nga Drejtoria e taksave nuk është krijuar një regjistër me të dhënat e mbi 10

kontratave të dhëna me qera për tokat bujqësore të pa ndara, pyjet për vendepozitim materialesh inerte, vendosje antenash televizori etj, si (data e kontratës, afati në vite, personat qeramarës dhe qeradhënës, shumat vjetore për tu paguar, pagesat vjetore, etj, të dhëna). Në kundërshtim me pikat 31 shkronjat “a” dhe “b” të UMF nr.30, datë 27.12.2011”Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

2. z. M.K. me detyrë inspektor në zyrën e shërbimeve, emëruar me Urdhrin nr. 70, datë 15.07.2007.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Për vitet 2013-2014 për 10 mjete që ka në përdorim Bashkia Poliçan, është harxhuar respektivisht 2678 litra/vit me vlerë 477,487 leë dhe 2846 litra/vit me vlerë 510,857 lekë ndërsa për vitin 2015 sasia e karburantit të harxhuar është rritur me 12,699 litra ose 4.5 herë më tepër se mesatarja e dy viteve 2013-2014 ose 9,853 litra në vlerën 1,670,835 lekë.

- Për caktimin e normativave të harxhimit të karburanteve nuk ka paraqitur dhe miratuar në Këshillin Bashkiak Poliçan, material për harxhimin e karburantit, për secilin mjet që disponon në inventar.

- Për mos ndjekjen, informimin dhe mos kryerjen e pagesës të taksave vjetore për asnjë vit dhe mos sigurimin e 12 mjeteve motorrike që disponon në inventar Bashkia Poliçan, apo që kanë ardhur nga 2 ish-komunat Vërtop dhe Terpan, duke mos paraqitur kërkesën për të bërë çregjistrimin e tyre në Drejtorinë Rajonale të Transporteve Berat, në kundërshtim me nenet 99-100 të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor në R.SH” i ndryshuar. Për pasojë për këto mjete Bashkia do të vazhdojë të paguaj taksat e prapambetura dhe kamat vonesat përkatëse duke shtuar shpenzimet e panevojshme.

C-II. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës

Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, neni 9, **i rekomandojmë** kryetarit të Bashkisë fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore, “Vërejtje” për 6 punonjësit e mëposhtëm:

1. z. Ç.B. inspektor në zyrën e tatim-taksave, emëruar me urdhrin nr. 08, datë 16.02.2010 trajtuar me Kodin e punes kontrata datë 16.07.2007 e në vazhdim, për mospërbushje të detyrës funksionale.

2. z. K.K. me detyrë, agjent tatimor Komuna Vërtop, emëruar me urdhrin nr. 22, datë 01.10.2009, me urdhrin nr.06, datë 04.02.2014, përgjegjës i zyrës taksave dhe me urdhrin e kryetarit të bashkisë, nr.112, datë 06.08.2015 është emëruar specialist tatimesh dhe administrimit të taksës së tokës bujqësore e në vazhdim.

3. z. A.S. me detyrë, agjent i administrimit të taksës bujqësore në Njësinë administrative Vërtop, me vendimin nr. 10 datë 25.05.2010 ka qenë emëruar Drejtori i Taksave, ish-komuna Vërtop dhe me urdhrin e kryetarit të bashkisë nr. 112, datë 06.08.2015 është emëruar inspektor i taksave në Njësinë administrative Vërtop.

4. z. D.D. me detyrë inspektor i taksave dhe administrimit të taksës së tokës Njësia administrative Terpan, emëruar me urdhrin e kryetarit të bashkisë nr. 113, datë 06.08.2015.

Për shkeljet e mëposhme:

- Pas kryerje së reformës administrative dhe kalimi i aktivitetit të bizneseve Bashkisë Poliçan 2 inspektorët e Njësisë administrative Vërtoq dhe inspektori i taksave Njësia administrative Terpan, nuk kanë dorëzuar numrin e bizneseve me Inventar në Drejtorinë e taksave Poliçan, pasqyrën e debitorëve të krijuar sipas viteve, llojin e aktivitetit, ngarkesat dhe arkëtimet, veçanërisht **debitorët e taksës së tokës** të cilët ishin dorëzuar në total dhe nuk disponohen me lista emër për emër, detyrimi dhe pagesa për secilin vit dhe në formë elektronike. Duke shkelur VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit,aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial".

- Mos dorëzimi i detyrës me proces verbal të listave të debitorëve është në kundërshtim edhe me pikat 10 dhe 13, të udhëzimit Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" Kap I. Të përgjithshme - Përgjegjësia e menaxhereve të tjere, nëpunësve dhe punonjesve publike,

- Nga puna e pamjaftueshme e 2 punonjësve të Njësisë administrative Vërtoq kanë lejuar që nga 1950 familje, më datën 31.12.2015 në njësinë administrative Vërtoq, janë debitorë për taksën e tokës 997 familje në vlerën 13,499,085 lekë nga të cilat 204 familje, nuk kanë paguar fare taksën e tokës.

- Nga puna e pamjaftueshme e inspektorit të Njësisë administrative Terpan, ka lejuar që nga 1591 familje, më datën 31.12.2015 të jenë debitorë 1185 familje në vlerën 29,216,879 lekë, nga të cilat 494 familje nuk paguajnë fare taksën e tokës që nga viti 2003.

- Për arkëtimin e taksave janë mjaftuar vetëm me moskryerjen e shërbimeve,duke mos njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të Njoftim Vlerësimit, apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga ish-Këshilli i Komunës Vërtoq dhe Këshilli Bashkiak Poliçan, në kundërshtim me pikën 52, të Udhëzimit Plotësues të buxhetit të Ministrisë Financave nr. 03,datë 17.01.2014 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2014".

- Për mos nxjerrjen e Njoftim Vlerësimit tatimor, për 997 familje të cilët janë debitorë më datën 31.12.2015 në vlerën 13,499,085 lekë, në kundërshtim me nenin 70, pika 3 "E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor", të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore" i ndryshuar.

5. znj. L.Xh. me detyrë ish-Drejtores e burimeve njerëzore për periudhën 2013-2014 deri në muajin gusht 2015 njëherazi edhe Nënkryetare e Bashkisë.

-Për shkeljet e mëposhtme:

-Për të 3 vitet objekt auditimi 2013,2014 dhe 2015 për 5 punonjësit që trajtohen me statutisin e nëpunësit civil, **nuk ka kryer vlerësimin vjetor të punonjësve**, në zbatim të neneve 16 dhe 29 të ligjit nr. 8549,datë 11.11.1999"Statusi i nëpunësit civil", udhëzimi i KM nr 5.datë 19.12.2007"Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 2, datë 07.07.2000"Për sistemin e vlerësimit të arritjeve vjetore individuale të nëpunësve civilë", neneve 62 dhe 69 -Vlerësimi i rezultateve në punë, të ligjit nr. 152/2013,"Për Nëpunësit Civil" dhe VKM nr. 109, datë 26.02.2014 "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësit civil", mbështetur në ligjin

-Për mos nënshkrimin e listëpagesave të punonjësve nga menaxheri i Burimeve Njerëzore në kundërshtim me pikën 69, të udhëzimin e Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

- Ka lejuar që për periudhën e audituar për vitin 2013-2015 janë marrë në punë **81 punonjës** jo nëpërmjet procedurës konkurimit, por janë marrë me akt emërimi, kontratë pune. Për marrjen në punë të këtyre punonjësve nuk janë zbatuar procedura të parashikuara nga kreu IV, “Pranimi në shërbimin civil” të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndyshuar.

6. znj. A.K. me detyrë arkëtare.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Për pranimin dhe arkëtimin e lekëve gjatë vitit 2105, pa nënshkruar mandat arkëtimet e arkës, nga nëpunësi zbatues, drejtores e Financës.

-Edhe pse ka zbatuar urdhrin e kryetarit të Bashkisë **z.A.Z.** nr. 35, datë 23.01.2015 i cili i është adresuar për zbatim arkëtares, pranimi dhe kryerjen e pagesave, nëpërmjet arkës, pa u nënshkruar nga drejtores e financës, ndaj 5 subjekteve private në vlerën **712,040 lekë**, është në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” kapitulli II, Dokumentimi i vlerave monetare dhe letrave me vlere, pika 68, ku në mënyrë eksplicite shkruhet se. Dokumentet e arkës shqyrtohen, kontrollohen dhe nënshkruhen nga personat e poshtëshënuar;

a. mandatarkëtimi nënshkruhet nga personi përgjegjës për vlerat monetare, nga punonjësi që kryen derdhjen dhe **nga nepunësi zbatues** ose i deleguari i tij;

b.mandat pagesa nënshkruhet nga **nepunësi zbatues** ose i deleguari i tij, nga marrësi i parave dhe nga personi përgjegjës për levizjen e vlerave monetare.

-Pagesa ndaj 5 subjekteve private në vlerën **712,040 lekë**, është kryer në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe konkretisht; neni 22,-Veprimtaritë e kontrollit Pika 3. *Ku përcaktohet se:* Veprimtaritë e kontrollit përmbajnë, minimalisht:

b) ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, sipas udhëzimit të Ministrisë të Financave;

c) sistemin e dy nënshkrimeve, i cili nuk lejon që angazhimi financiar të kryhet pa marrë nënshkrimet e nëpunësit autorizues dhe të nëpunësit zbatues të njësisë;

ç) sistemin e dy nënshkrimeve, i cili nuk lejon që pagesa të kryhet pa marrë nënshkrimet e nëpunësit autorizues dhe të nëpunësit zbatues të njësisë apo të nëpunësve të deleguar prej tyre;

D. MASA ADMINISTRATIVE:

Bazuar në germën “ç” të nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 7 pika 2, 3/a ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” i rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik, që në zbatim të nenit 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe Kreu X i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar:

D. I Të shqyrtojë dhe të marrë masa disiplinore ndaj anëtarëve të Komisioni Vlerësimit të Ofertave, *konkretisht:*

1. L.Xh. me detyrë nënkryetarë e Bashkisë, antare e KVO

2. K.B. Specialist në zyrën e urbanistikës, antar i KVO

3. R. B, Drejtor i Ndërmarrjes Shërbimeve, antar i KVO

1. Për prokurimin publik me objekt “Rikonstruksioni i Kopshtit nr. 2”:

Nga auditimi i procedurave në sistem dhe dokumentacionit të paraqitur nga operatorët pjesëmarrës konstatohet se OE “R...” i skualifikuar me arsyetimin se nuk ka paraqitur licencën profesionale individuale, ka një mangësi dokumentacioni ligjor me devijime të vogla dhe KVO gjatë verifikimit në sistem të dokumentacionit duhet të vlerësonte kapacitetin teknike të OE “R...” dhe ti kërkonte plotësim të dokumentacionit gjatë momentit të rivlerësimit ose edhe pasi ta kishte kualifikuar si oferta ekonomike e favorshme, pasi plotësimi i mangësisë në vetëm 1 dokumentacion mbështetës nuk do të sillte deformim të ofertës në përmbushje të detyrimeve të nenit 53 dhe 54 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” hynë te devijimet e vogla dhe KVO duhet ti kishte kërkuar arsyetim operatorit konkurrues duke parë ofertën ekonomike favorizuese të këtij operatori.

Për sa më sipër vlerësojmë se Vlerësimi i KVO-së në përzgjedhjen e ofertës fituese është në kundërshtim me nenet 20, 46, 53, 54 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kreun V i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi ka skualifikuar ofertues të cilët plotësojnë kriteret për kualifikim *me devijime të vogla të pranuar nga ligji, duke shkaktuar efekt financiar negativ për buxhetin e Bashkisë Poliçan në vlerën 663,420 lekë.*

2. Për prokurimin publik me objekt “Rikonstruksioni i godinës Administratës”:

Nga auditimi i procedurave në sistem dhe dokumentacionit të paraqitur nga operatorët pjesëmarrës konstatohet se OE “A” i skualifikuar me arsyetimin se nuk ka paraqitur formularin e sigurimit të ofertës, është jo i saktë pasi KVO gjatë verifikimit në sistem të dokumentacionit duhet të vlerësonte ofertën e favorshme ekonomike, kapacitetin teknike dhe financiare të OE “A” dhe ti kërkonte plotësim të dokumentacionit gjatë momentit, pasi dhe në DST njësia e prokurimit formularin e sigurimit të ofertës e ka kërkuar nëse zbatohet, dhe në këto rrethana KVO duhet të merrte në shqyrtim si bazë ligjore edhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenit 18 “sigurimi i ofertës” i cili parashikon: *“Në procedurat e prokurimit me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin sigurimin e ofertës, sipas këtij neni. Në këtë rast, sigurimi i ofertës ka formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari”* në këto rrethana dhe në qoftë se KVO do të ishte treguar fleksibël në vlerësimin e kriterëve të vendosura nga NJP, në përmbushje edhe të detyrimeve të nenit 53 dhe 54 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” KVO duhet ti kishte kërkuar arsyetim operatorit konkurrues dhe kualifikuar atë, mos kryerja e këtyre arsytiveve nga KVO ka bërë në përzgjedhjen e ofertës fituese është në kundërshtim me nenet 46, 53, 54 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kreun III, neni 18 i VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, *duke shkaktuar efekt financiar negativ për buxhetin e Bashkisë Poliçan në vlerën 237,354 lekë.*

F. Auditimi vlerësohet dobët nga Kryetari dhe do të auditohet në një kohë të dytë, ose në auditimin e radhës periudha objekt auditimi e këtij raporti do të riauditohet.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor si dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R